



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 439/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Nenad Laziq dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Adem Salihaj nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Miratohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Adem Salihaj, nga radhët e subjekti politik LDK, dega në Ferizaj,
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin (VV), 2501y/08R
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve të VV si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës-Adem Salihaj me nr. 23 nga radhët e subjekti politik LDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendon se komisionarët e vendvotimit (VV) 2501y/08R nuk ia kanë shënuar votat fare në numrin 23 në FRK.

Parashtresuesi i ankesës në cilësinë e provës ka ofruar: Deklaratën e Komisionares Hatixhe Abdullahu dhe Formularin e Rezultatit për Kandidat.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka konstatuar se nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga shqyrtimi dhe hetimi i bërë në materialin zgjedhor të QV 2501y/08R, në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) në rubrikën e kandidatit me nr 23 nga radhët e subjektit politik LDK, Adem Salihaj, shihet qartë se në rubrikën e tij nuk ka të shënuar asgjë.

PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotime të lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 439/2014 më datën 30.06.2014.



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*